

EDUKIMI NË DREJTËSINË TRANZICIONALE NË KOSOVË:

DOKUMENT I POLITIKËS SË AVOKIMIT PËR PËRFSHIRJEN E DREJTËSISË  
TRANZICIONALE NË PLANPROGRAMET ZYRTARE TË SHKOLLËS SË MESME

**Dhjetor 2015**

## **Tabela e përmbajtjes**

### **Përmbledhje e ekzekutive**

#### **I. Hyrje**

#### **II. Deficiti i njohurive dhe mungesa e edukimit lidhur me drejtësinë tranzicionale: sfidat**

1. Deficiti i shumëfishtë edukativ
2. Mungesa e qasjes arsimore në Kosovë: rinia e painformuar dhe e keqinformuar
3. Deficiti i njohurive të përgjithshme: konteksti i jetesës së rinisë së Kosovës

#### **III. Pasojat dhe sfidat e deficitit të njohurive dhe mungesa e edukimit lidhur me drejtësinë tranzicionale**

#### **IV. Kundërvënja deficitit të njohurive: edukimi i rinisë së Kosovës, një prerogativë dhe përgjegjësi e Shtetit**

#### **V. Konkluzion dhe rekomandime**

#### **VI. Aneksat**

1. Lista e punëtorive të mbajtura në vitin 2015
2. Model i analizës së formularëve të vlerësimit të plotësuar nga nxënësit
3. Pjesë nga Manuali i FDH-së mbi Drejtësinë Tranzicionale
4. Raport i QNDT i vitit 2015: Arsimi dhe Drejtësia Tranzicionale

## **Përmbledhje e ekzekutive**

Rinia e Kosovës aktualisht nuk është duke mësuar lidhur me çështjet e drejtësisë tranzicionale, që do të thotë ka një deficit brengosës të njohurive lidhur me rëndësinë e trajtimit të së kaluarës. Në mënyrë më të përgjithshme, ky deficit i njohurive është një tipar karakteristik i shoqërisë së Kosovës si tërësi.

Kjo situatë ka pasoja afatgjata për pajtimin, qëndrueshmërinë shoqërore dhe paqen pozitive. Duke e pasur parasysh se rinia e Kosovës e përbënë të ardhmen e vendit dhe se të rinjtë janë pre e versioneve të politizuara dhe të manipuluar të historisë, është me rëndësi kyçe për të investuar në edukimin e tyre dhe për prezantimin e tyre me njohuri të bazuara në faktet mbi këtë çështje.

Ky dokument hulumton sfidat që rezultojnë në mungesë të drejtësisë tranzicionale dhe arrin në përfundimin se aksionet e imta që ndërmerren për të trajtuar këtë çështje janë të pamjaftueshme. Së këndejmi, ai avokon përfshirjen e një kapitulli mbi drejtësinë tranzicionale në planprogramin e edukatës qytetare të shkollave.

## I. HYRJE

Në vitin 2004, Kombet e Bashkuara kanë dhënë një përkufizimin të drejtësisë tranzicionale, i cili përfshin “*shkallën e plotë të proceseve dhe të mekanizmave të ndërlidhura me përpjekjet e shoqërisë për t’u ballafaquar me trashëgiminë e abuzimeve të shkallës së gjerë në të kaluarën, me qëllim që të sigurojë llogaridhënien, t’i shërbejë drejtësisë dhe të arrijë pajtimin. Këtu përfshihen si mekanizmat gjyqësorë ashtu edhe ato jo-gjyqësore, me nivele të ndryshme të përfshirjes ndërkombëtare [...] dhe ndjekjet penale individuale, reparacionet, kërkimi i së vërtetës, reforma institucionale, verifikimet dhe shkarkimet ose një kombinim i këtyre të dyjave.*”<sup>1</sup>

Në të vërtetë, drejtësia tranzicionale mbulon një shkallë të gjerë të instrumenteve, të cilat mund të grupohen në 4 shtylla kryesore: ndjekja penale, nismat e kërkimit të së vërtetës, reparacionet dhe reformat institucionale.<sup>2</sup> Kjo larmi e instrumenteve e ilustron larminë e qëllimeve të drejtësisë tranzicionale, që i shërbejnë të drejtave të ndryshme të viktimës:

- Sigurimit të përgjegjësisë penale dhe garantimit të llogaridhënies – *duke e plotësuar të drejtën në drejtësi;*
- Sigurimit të reparacioneve materiale dhe simbolike për viktimat – *duke e përmbushur të drejtën e tyre në korrigjim/reparacione;*
- Paraqitjes së një të vërtete të përbashkët lidhur me atë se çfarë ka ndodhur – *duke përmbushur të drejtën për të ditur dhe*
- Promovimit të pajtimit individual dhe kombëtar dhe mundësive për paqe në shtigje afatgjata përmes reformës institucionale dhe progresit drejt sigurisë dhe zhvillimit – *duke e përmbushur të drejtën e garantimit të mos-përsëritjes së abuzimeve të së kaluarës.*

Derisa të gjitha këto elemente të Drejtësisë Tranzicionale janë të rëndësishme dhe komplementare, aspekti edukativ i tyre është qendra e këtij dokumenti, për arsye se i ndërton dy elemente të domosdoshme të suksesit të Drejtësisë tranzicionale: kujtesën kolektive për të kaluarën dhe një gjeneratë të re të informuar.

Edukimi i rinisë së Kosovës mbi çështjet e drejtësisë tranzicionale dhe pajisja e tyre me shkathtësitë e të menduarit kritik është një element kyç për nxitjen e pajtimit dhe për sigurimin e paqes pozitive. Edukimi, posaçërisht në fushën e historisë dhe të edukimit qytetar, luan një rol të madh në formimin e qytetarëve produktiv, të preokupuar dhe politikisht të angazhuar, i bart shkathtësitë dhe vlerat e domosdoshme për një jetë demokratike si dhe siguron se vendi nuk do të bie prapë viktimë e konflikteve etnike.<sup>3</sup> Në kuptimin ekonomik,

<sup>1</sup> Raport i SPKB mbi Sundimit e Ligjit dhe DT në Shoqëritë Post-Konfliktuale dhe atë në Konflikt (S/2004/616) në dispozicion në: <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N04/395/29/PDF/N0439529.pdf>

<sup>2</sup> Një hyrje e hollësishme në ato instrumente mund të gjendet në aneksin 3.

<sup>3</sup> Përfitimet e mësimi se si të trajtohet e kaluara janë evidente në punën me faktorët ndërkombëtarë, siç është Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian ose Kombet e Bashkuara si dhe në diskutet akademike. Për shembujt e kohëve të fundit: Këshilli i Bashkimit Evropian, [Mbështetja e BE-së ndaj Drejtësisë Tranzicionale – Konkluzionet e Këshillit \(EU’s support to transitional justice - Council conclusions\)](#) (16 nëntor 2015), 13576/15; Këshilli për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara, [Raport i Raportuesit Special mbi promovimin e së vërtetës, drejtësisë, reparacionit dhe garancitë e mos-përsëritjes \(Report of the Special Rapporteur on the promotion of truth, justice, reparation and guarantees of non-recurrence\)](#), Pablo de Greiff, 9 gusht 2012, A/HRC/21/46 ose Këshilli i Evropës, [Rekomandimet \(Recommendation\) 1880 \(2009\)](#), *Historia e mësimi në zonat e konfliktit dhe ato të post-konfliktit (History teaching in conflict and post-conflict areas)*

një rini e Kosovës e edukuar është çelësi i sigurimit të zhvillimit ekonomik.<sup>4</sup> Kjo është posaçërisht e rëndësishme ngaqë 70% e popullatës së Kosovës është nën moshën 35 vjeçare dhe ngaqë rinia e saj përbënë të ardhmen e vendit.<sup>5</sup>

FDH Kosovë në mënyrë vazhdueshme ka qenë i mendimit se edukimi i nxënësve të shkollave të mesme lidhur me drejtësinë tranzicionale është i një rëndësie të madhe me qëllim që atyre t’iu mundësohet për të zhvilluar shkathtësitë e nevojshme të qytetarisë aktive. Nxënësit e shkollave të mesme kanë nevojë që atyre t’iu paraqiten faktet në lidhje me konfliktet e kohëve të fundit si dhe ata kanë nevojë për të kuptuar domosdoshmërinë e trajtimit të së kaluarës me qëllim që t’i shmangen ndikimeve nga versionet e politizuara dhe të manipuluar të historisë.

Që nga viti 2011, si pjesë e Programit të Drejtësisë Tranzicionale, FDH Kosovë ka implementuar Programin e saj të Edukimit Jo Formal mbi Trajtimin e së Kaluarës (EJFTK), përmes të cilit mban punëtori edukuese lidhur me drejtësinë tranzicionale në shkollat e mesme anë e kënd Kosovës. Gjatë atyre punëtorive, nxënësve iu shpjegohen katër shtyllat e drejtësisë tranzicionale dhe implementimi i tyre në Kosovë dhe lihet hapësirë për debat dhe diskutim. Vetëm në vitin 2015, FDH Kosovë ka mbajtur 16 punëtori në shkolla të mesme të ndryshme në Kosovë, duke mbuluar gjithsejtë mbi 591 nxënës.<sup>6</sup> Prej këtyre punëtorive, një punëtori është mbajtur në shkollën e mesme serbe në fshatin Verboc.

Gjetjet e FDH Kosovë mbi marrëdhënien e shoqërisë kosovare ndaj së kaluarës janë alarmuese. Në Kosovë, në masë të madhe mbizotërojnë mungesa e njohurive dhe e vetëdijes lidhur me konfliktet e kohëve të fundit dhe për rëndësinë e trajtimit të së kaluarës. Kjo ka pasoja të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Ende nuk është arritur pajtimi dhe ndarjet dhe stereotipet etnike ende mbesin një karakteristikë e rëndësishme e shoqërisë kosovare, posaçërisht në kohën kur vendi është duke kaluar nëpër një krizë ekonomike dhe politike. Jo vetëm kaq, instrumentet e drejtësisë tranzicionale në masë të madhe nuk njihen dhe janë të keqkuptuar. Shkaqet e këtij deficiti të njohurive janë të shumëfishta, por mungesa e qasjes institucionale drejt edukimit të të rinjve lidhur me drejtësinë tranzicionale është një faktor i rëndësishëm.

Edhe pse diskursat politike akademike dhe ndërkombëtare i kanë kushtuar një vëmendje të qëndrueshme edukimin në lidhje me trajtimin e së kaluarës dhe rëndësisë së reformës arsimore në periudhën e tranzicionit, përgjigjja politike në Kosovë ka qenë e pa bashkërenditur dhe në masë të madhe e pamjaftueshme. Mbase edhe më alarmuese, nuk ka përpjekje, madje as për të diskutuar, rëndësinë e futjes së çështjeve të drejtësisë tranzicionale brenda arsimit, qoftë në nivel lokal, kombëtar ose rajonal.

---

<sup>4</sup> Një sasi substanciale e punës akademike dhe e politikës mbi arsimin e ka lidhur arsimin me zhvillimin e qëndrueshëm. Për shembull, Arsimit, Qëllimet e Qëndrueshme Zhvillimore të Kombeve të Bashkuara (United Nations a Sustainable Development Goals (SDGs)). Për shembujt e kohëve të fundit: OECD (Organizata për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim, OBEZH (2015), *Shkathtësitë Universale Bazike: Çfarë synojnë vendet për të fituar (Universal Basic Skills: What Countries Stand to Gain*, OECD Publishing); UNESCO, *Strategjia e Arsimit UNESCO, Education Strategy 2014-2021* (2014), ose UNESCO, Forumi i Arsimit Botëror (World Education Forum) 2015, *Deklarata e Incheonit Edukimi 2030: drejt arsimit përfshirës dhe cilësor dhe mësimi gjatë gjithë jetës për të gjithë (Incheon Declaration, Education 2030: Towards Inclusive and quality education and lifelong learning for all)*, ED/WEF2015/MD/3 (‘Ne riafirmojmë se arsimit është e mirë publike, e drejtë fundamentale e njeriut dhe bazë për garantimin e realizimit të të drejtave të tjera. Është thelbësor për paqen, tolerancën, realizimin njerëzor dhe zhvillimin e qëndrueshëm.’)

<sup>5</sup> Shifrat nga Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë e Kosovës, në dispozicion [këtu](#).

<sup>6</sup> Shih aneksin 1.

Ky dokument, i cili bazohet në gjetjet e FDH Kosovë përmes programit të tij për Drejtësinë Tranzicionale, do të parashtrijë në hollësi sfidat, të shkaktuara nga deficitet e njohurive të rinisë së Kosovës në lidhje me drejtësinë tranzicionale, dhe do të argumentojë për miratimin e një politike arsimore afatgjatë mbi këtë çështje. Në veçanti, ky dokument avokon për futjen e një kapitulli mbi drejtësinë tranzicionale në planet dhe programet e edukatës qytetare të shkollave të mesme. Bashkëngjitur me këtë dokument është Raporti më i fundit i Qendrës Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (ICTJ) mbi edukimin dhe drejtësinë tranzicionale, i cili i tregon mënyrat përmes të cilave edukimi mund t'i kontribuojë paqes pozitive ose se si mund t'iu fryjë zjarrit të konfliktit nëse nuk realizohet.<sup>7</sup>

## **II. DEFICITI I NJOHURIVE DHE MUNGESA E EDUKIMIT LIDHUR ME DREJTËSINË TRANZICIONALE: SFIDAT**

Deficiti i njohurive, i vëzhguar nga FDH Kosovë, shtrihet nëpër shumë gjenerata dhe ndikon mbi të gjithë shoqërinë.

### **1. Deficiti i shumëfishtë edukativ**

Fundi i konflikteve të viteve 1990-të nuk e ka sjellë pranimin e përgjithshëm të fakteve dhe të shifrave midis palëve, shkaqet e konflikteve dhe pasojat e tyre ose mënyrën se si duhet të trajtohen ato. As farë marrëveshje nuk është arritur midis të dyja palëve lidhur me atë se si duhet të bëhet mësimi mbi konfliktet dhe trashëgiminë e tyre, lidhur me atë se çfarë faktesh të paraqiten në tekstet shkollore si dhe, në përgjithësi, në lidhje me rëndësinë e trajtimit të së kaluarës. Nuk janë përgatitur mësues, që trajtojnë rëndësinë e trajtimit të së kaluarës ose lidhur me atë se si duhet t'i qasemi kësaj çështjeje. Tekstet shkollore shpesh paraqesin fakte të paragjykuara dhe vazhdojnë për të përjetësuar stereotipat dhe pikat e tensioneve të mundshme etnike. Pos kësaj, ato nuk përfshijnë kurrfarë shpjegimi lidhur me atë se çka janë mekanizmat e drejtësisë tranzicionale si dhe lidhur me atë se si janë zgjedhur dhe implementuar ato në Kosovë që nga lufta.

Situata është edhe më problematike kur të kihet parasysh se nxënësit nga komunitetet etnike shqiptare dhe serbe mësojnë nga planprograme të ndryshme, përkatësisht nga planprograme të hartuara nga MASHT e Kosovës dhe Ministria e Arsimit e Serbisë. Asnjëra palë nuk i trajton çështjet që kanë të bëjnë me drejtësinë tranzicionale si dhe as që duket se e trajtojnë rëndësinë dhe nevojën për trajtim të së kaluarës. Përvojat e FDH Kosovë tregojnë se mospërputhjet mbesin në mënyrën se si komunitetet shqiptare dhe serbe i trajtojnë çështjet e drejtësisë tranzicionale dhe kjo rezistencë është shumë më e fortë tek komuniteti serb në Kosovë. Përkundër përpjekjeve të numërta për të organizuar punëtorë në shkollat e mesme serbe, FDH Kosovë ka qenë në gjendje për të mbajtur vetëm një punëtorë, në fshatin Verboc. Shumica e shkollave të tjera të kontaktuara kanë hezitur për të mbajtur punëtorë, shpesh duke u tërhequr nga pranimi i tyre fillestar pasi kanë bërë kërkime lidhur me punën e FDH-së në Beograd.

Dualiteti i programeve arsimore në Kosovë dhe mungesa e prirjes së tyre kundruall trajtimit të së kaluarës i kontribuon drejtpërdrejtë krijimit të deficitit arsimor në Kosovë dhe i helmon marrëdhëniet midis Kosovës, komunave me shumicë serbe, dhe Serbisë. Ndërsa një reformë

---

<sup>7</sup> Aneksi 4, QNDT dhe UNICEF, Clara Ramírez-Barat dhe Roger Duthie, *Edukimi dhe Drejtësia Tranzicionale, Shanset dhe Sfidat për Ndërtimin e Paqes*, Nëntor 2015 (ICTJ and UNICEF, Clara Ramírez-Barat and Roger Duthie *Education and Transitional Justice, Opportunities and Challenges for Peacebuilding*, Nov. 2015).

arsimore kombëtare lidhur me planet dhe programet arsimore në gjuhën shqipe dhe serbe është e nevojshme, ky dokument fokusohet, për arsye pragmatike, vetëm në ndryshimet arsimore të ndërmarra nga Ministria e Arsimit e Kosovës.

## **2. Mungesa e qasjes arsimore në Kosovë: rinia e painformuar dhe e keqinformuar**

Deficiti arsimor lidhur me çështjet e drejtësisë tranzicionale drejtpërdrejtë mund të shprehet si një fenomen i gjerë i keqkuptimit dhe i konceptimit të gabuar. Gjetjet e FDH Kosovë tregojnë se nxënësve iu mungojnë njohuritë e bazuara mbi faktet dhe të kuptuarit e konflikteve si dhe se ata nuk janë të pajisur me shkathësitë e nevojshme për trajtimin e kësaj të kaluarë. Kjo, për pasojë, është duke e zvogëluar ndikimin, të cilin ndërmarrjet e drejtësisë tranzicionale, të zgjedhura për Kosovën, mund të kenë mbi shoqërinë.

### ***Keqkuptimi i fakteve të luftës nga nxënësit***

Nxënësit në Kosovë kanë një vizion të shtrembëruar të ngjarjeve të luftës. Ata, në masë të madhe, i mbivlerësojnë dëmet e lidhura me luftën: kur iu është shtruar pyetja lidhur me këtë, disa nxënës sinqerisht janë përgjigjur se ata kanë menduar se konflikti ka rezultuar me mbi 300,000 vdekje.<sup>8</sup> FDH Kosovë po ashtu ka vërejtur modele, të cilat tregojnë mungesën e njohurive të nxënësve në lidhje me numrat e viktimave nga komunitetet e tjera: në mënyrë të shënueshme, shumë nxënës shqiptar etnik besojnë se nuk ka pasur viktimitë etnike serbe. Ky keqkuptim mund t'ia hap rrugën manipulimeve dhe formimit të narrativave të pasaktë lidhur me të kaluarën, dekonstruktimi i së cilës është saktësisht objektiv i mekanizmave të drejtësisë tranzicionale në Kosovë.

### ***Mungesa e njohurive për drejtësinë tranzicionale nga nxënësit***

Sidoqoftë, matanë keqkuptimit lidhur me faktet dhe pasojat e konfliktit, përvoja e FDH-së ka provuar se fëmijët në shkollat e mesme pothuajse nuk kanë njohuri për instrumentet dhe konceptet e drejtësisë tranzicionale. Kur iu janë prezantuar mekanizma të ndryshëm të drejtësisë tranzicionale në Kosovë në veprim (gjykatat ndërkombëtare dhe vendore, nismat e kërkimit të së vërtetës, reparacionet dhe reforma institucionale), 95% e nxënësve e kanë pranuar se janë duke mësuar diçka që më parë e kanë injoruar.<sup>9</sup> Shumica prej tyre kanë hasur në instrumentet e drejtësisë tranzicionale deri në njëfarë pike, por pa qenë të vetëdijshëm se për çka është fjala si dhe pa e ditur se çfarë objektivave iu shërbejnë. Më e rëndësishmja, pothuajse asnjëri prej tyre nuk ka mundur për të shpjeguar dallimin midis tyre (për shembull, midis Gjykatës Ndërkombëtare për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi (GJNKJ) dhe Misionit të Sundimit të Ligjit të Bashkimit Evropian në Kosovë (EULEX) ose rreziqeve që përmbajnë ato brenda vetes (për shembull, rreziqet e memorializimit të pasaktë ose të programeve të paragjykuara të reparacioneve).<sup>10</sup>

### ***Vazhdimësia e ndjenjave negative gabimisht të informuara***

Angazhimi i nxënësve në drejtësinë tranzicionale dhe qasja ndaj drejtësisë tranzicionale dallojnë në pajtim me rajonin e origjinës. Në rajone posaçërisht të dëmtuara gjatë luftës dhe

<sup>8</sup> Sipas informacionit të FDH Kosovë, 13,549 persona kanë vdekur gjatë konfliktit, nga data 1 janar e vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000, prej të cilëve 10,829 kanë qenë shqiptarë, 2,199 kanë qenë serb dhe 529 romë.

<sup>9</sup> Shih aneksin 2.

<sup>10</sup> Detajet e kësaj diference dhe rreziqet mund të gjenden në aneksin 3.

në të cilat nxënësit personalisht kanë humbur ose e kanë ditur se ka pasur viktime në komunitetin e tyre, pjesëmarrësit kanë qenë më të gatshëm për të biseduar për viktimat dhe krimet e kryera nga të dyja anët. Në disa pjesë të Kosovës, ku nxënësit nuk i janë ekspozuar drejtpërdrejtë mizorive të luftës, në anën tjetër, nxënësit janë më të prirë për të biseduar për viktimat nga komuniteti i tyre etnik dhe për kryerësit e krimeve të komunitetit tjetër. Këta nxënës përgjithësisht shfaqin deri diku mungesë të bashkëndjesisë për viktimat me prejardhje tjetër etnike dhe tregojnë gatishmëri më të madhe për të paraqitur justifikimin për krimet e kryera nga personat me prejardhje të njëjtë etnike.

Gjetjet e FDH Kosovë tregojnë se mungesa e informacionit të saktë mbi të kaluarën e afërt në Kosovës dhe masat e drejtësisë tranzicionale, me gjithë dallimet rajonale, përgjithësisht shoqërohet nga një vazhdimësi të qëndrueshme të ndjenjave negative dhe të stereotipeve kundruall grupeve të tjera etnike. Qëndrimet e tilla ushqejnë diskursin e rrezikshëm të “neve kundër tyre” dhe iu fryjnë përçarjeve etnike. Kjo është pasojë e drejtpërdrejtë e mungesës së njohurive që është vëzhguar në mesin e rinisë në Kosovë.

### **3. Deficiti i njohurive të përgjithshme: konteksti i jetesës së rinisë së Kosovës**

Mungesa e njohurive të bazuara në faktet dhe e të kuptuarit të konflikteve dhe e masave të drejtësisë tranzicionale evident në mesin e të rinjve të Kosovës është posaçërisht problematik në dritën e kontekstit shoqëror, që po ashtu karakterizohet me deficitin e njohurisë. Shumica e kosovarëve kanë një vetëdije të fortë të konflikteve të viteve 1990-të, posaçërisht përmes historive të tyre personale ose familjare, por atyre iu mungon një të kuptuar i papasion, i bazuar në faktet dhe neutral. Shoqëria kosovare si tërësi mbetet e pandërgjegjshme për mekanizmat e drejtësisë tranzicionale si dhe rolin dhe rëndësinë e tyre, dhe, në masë të madhe, kjo shoqëri është e ndikuar nga mediat, raportimi i të cilave mbi këtë çështjen shpesh është anues, sensacionalistik dhe jo i dokumentuar mirë. Për shembull, shumë kritika të topitura të mediave mund të dëgjohen në drejtim të punës së EULEX-it ose të Tribunalit të Hagës (ICTY), që e minojnë punën e tyre dhe mund të pengojë punën e Dhomave të Ardhshme Speciale për Kosovën, në mungesë të një zëri zyrtar të paanshëm për t’iu kundërvënë atyre.

Në dritën e këtij konteksti të njollosur nga një deficit i njohurive të përgjithshme, rinia e Kosovës duket si një shënjestër e parë për edukimin me drejtësinë tranzicionale, jo vetëm për arsye se ata përbëjnë të ardhmen e vendit, por, po ashtu, edhe për arsye se ata janë posaçërisht të ndjeshëm ndaj të qenit të ndikuar nga versionet e manipuluar ose të politizuara të historisë dhe mund të përfundojnë si një shtesë në injorancën e përgjithshme në lidhje me këto çështje.

### **III. PASOJAT DHE SFIDAT E DEFICITIT TË NJOHURIVE DHE TË MUNGESËS SË EDUKIMIT PËR DREJTËSINË TRANZICIONALE**

Deficiti i përgjithshëm i njohurive që përshkon shoqërinë kosovare dhe mungesa e qasjes edukative për drejtësinë tranzicionale ka pasoja të drejtpërdrejta.

Duke mos e pasur një prezantim objektiv, një qasje të bazuar në faktet të ndërgjegjshme për shumësinë e viktimave, nxënësit kosovar nuk janë të pajisur me mjetet e nevojshme për t’iu kundërvënë retorikës së politizuar ose nacionaliste. Stereotipat, perceptimet e pasakta dhe diskursat diskriminuese kanë gjasë që të bëhen më me ndikim dhe nxënësit do të shndërrohen



në një gjeneratë të ardhshme të pandërgjegjshëm për nevojën për t'i gjetur ato. Të kombinuara me garën e pandërprerë për viktimizim ekskluziv, që buron nga mungesa e njohurive të nxënësve në lidhje me numrin e viktimave, kjo situatë përbënë një kërcënim për pajtimin dhe për konsolidimin e një demokracie shumetnike dhe përfshirëse të Kosovës – një kusht i cili kërkohet për rrugën për qasje në BE.

Jo vetëm kaq, mungesa e njohurive nga të rinjtë lidhur me mekanizmat e drejtësisë tranzicionale është duke e penguar efikasitetin e tyre. Në të vërtetë, sukcesi i drejtësisë tranzicionale është jashtëzakonisht i varur nga perceptimi dhe përkrahja publike. Përkrahja e tillë përfshin ndërtimin e një të kuptuari të mjeteve të drejtësisë tranzicionale me anë të edukimit lidhur me mandatin, me objektivat dhe me specifikat e tyre. Në mungesë të një arsimimi të tillë, instrumentet e drejtësisë tranzicionale në Kosovë janë të keqkuptuara dhe të refuzuara dhe, së këndejmi, ndonjëherë kundërproduktive dhe joefikase. Për shembull, publiku i përgjithshëm në Kosovë, duke e përfshirë këtu edhe rininë, ka njohuri, të kuptuar dhe vetëdije shumë të kufizuar për gjykimet e krimeve të luftës të lidhura me konfliktet e fundit. Informacioni lidhur me gjykimet është i paktë, rrallë zë hapësirën e radhës së parë në rrjedhën e përgjithshme të mediave dhe tash nuk është i përfshirë në planprogramet e shkollës së mesme. Kjo mungesë e informacionit është duke e parandaluar të kuptuarit e njëmendët dhe përkrahjen e rinisë për gjykimet, duke i parandaluar ata, së këndejmi, që në mënyrë efikase t'i kontribuojnë ndërmarrjes së pajtimit.

Rrezikimi i pajtimit dhe i karakterit demokratik të Kosovës madje është edhe më i madh ngaqë mungesa e edukimit zyrtar për trajtimin e së kaluarës lë hapësirë për mënyra alternative të transmisionit, siç janë mediat ose historitë personale ose familjare, të cilat përgjithësisht janë subjektive, të paragjykuara dhe të politizuara. Duke e pasur parasysh se edukimi kultivon lidhje të ngushta me konceptet e identitetit kombëtar, qytetarisë, historisë së përbashkët dhe ndjenjës së përkatësisë, lënia e kësaj në kanalet jozyrtare është barazi me mohimin e prerogativave të shtetit për formimin e një identiteti të përbashkët dhe, së këndejmi, një kombi të fort.

Në shtigje afatgjata, kjo situatë është vetvetiu shkatërruese për paqen. Edukimi, i cili objektivist nuk i paraqet faktet dhe shifrat dhe nuk i nxit nxënësit që në mënyrë kritike të mendojnë për shkaqet e konflikteve, dështon për të ofruar çfarëdo garancie të mos-përsëritjes. Prapë, në dritën e krizës aktuale politike në Kosovë dhe të rishfaqjes së tensioneve etnike, është e një rëndësie kyçe për Kosovën për të ndërmarrë secilën masë për të parandaluar çfarëdo rishfaqje të konfliktit.

Përfundimisht, mungesa e edukimit lidhur me drejtësinë tranzicionale përbënë një shans të dështuar për shtetin Kosovës për të përfortuar besimin qytetar – aspekt i domosdoshëm dhe primordial i një demokracie funksionale –vis-à-vis si para institucioneve publike dhe qytetarëve, ashtu edhe midis qytetarëve. Në planin ndërkombëtar, mungesa e kanaleve të trajtimit të së kaluarës drejtpërdrejtë është duke pllakosur marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë dhe është duke ngadalësuar procesin e pranimit të Kosovës në BE.

Për t'i zmbarsur këto pasoja, është e domosdoshme për Kosovën për ta bërë rininë e saj shënjestër primare të një politike edukative, e cila e synon përhapjen e informacionit të saktë lidhur me të kaluarën e vendit si dhe ngritjen e vetëdijes mbi nevojën për të trajtuar atë dhe për mënyrat që janë në dispozicion për të bërë këtë. Një edukim i ofruar nga shteti në lidhje me rëndësinë e instrumenteve, me të cilat trajtohet e kaluara, e ka potencialin që në masë të

madhe të përmirësojë përkrahjen publike për drejtësinë tranzicionale dhe, së këndejmi, ndikimin e drejtësisë tranzicionale në masë të madhe.

Pikërisht ashtu siç deficitin e njohurive i gjithmbarshëm i njohurive i shoqërisë kosovare është duke ndikuar në rininë e saj, edukimi i të rinjve kosovar do të ndikojë në shoqërinë përmes efektit të përhapjes, qoftë përmes diskutimit të informacioneve, mediave sociale, qoftë përmes socializmit në masë të madhe.

#### **IV. LUFTIMI I DEFICITIT TË NJOHURIVE: EDUKIMI I RINISË SË KOSOVËS, NJË PREROGATIV DHE PËRGJEGJËSI E SHETIT**

Gjetjet e FDH Kosovë tregojnë se rinia e Kosovës vetvetiu është posaçërisht e favorizuar ndaj idesë për të mësuar për drejtësinë tranzicionale. Gjatë punësive, nxënësit përgjithësisht kanë treguar një interes të madh për çështjen dhe janë angazhuar në debat, shpesh duke kërkuar më shumë informacion. Një analizë me 100 pyetësor të plotësuar nga nxënësit në vitin 2015 ka çuar deri tek rezultate shumë pozitive: 95% e nxënësve kanë raportuar se ata kanë mësuar diçka për të cilën më herët nuk kanë qenë të ndërgjegjshëm gjatë punësive dhe vetëm 5% kanë raportuar se ata nuk mendojnë se informacioni do të ishte i dobishëm për ta në të ardhmen. Edhe pse punëtoritë kanë zgjatur 5 orë, shumica e nxënësve kanë konsideruar se ato duhet të zgjasin më shumë, duke pasur parasysh rëndësinë e çështjes. Në fund, 76% e nxënësve janë të mendimit se ky informacion ka qenë i rëndësishëm dhe se duhet të shtohet në tekstet e tyre shkollorë.<sup>11</sup> Këto rezultate tregojnë një interesim të njëmendët të rinisë për të kaluarën e vendit të tyre dhe për mekanizmat, me anë të të cilave duhet të merremi kur të trajtohet e kaluara. Një interesim i tillë bart potencialin i cili duhet të stimulohet dhe të çohet më tutje nga shteti.

Krahas këtyre punësive, FDH Kosovë ka punuar drejt sjelljes së drejtësisë tranzicionale përmes mjeteve kreative, posaçërisht përmes partneritetit me festivalin e filmit dokumentar DOKUFEST, i cili mbahet në baza vjetore në Prizren. Është po ashtu inkurajuese për studentët që të angazhohen në çështjen e drejtësisë tranzicionale, qoftë përmes shkrimit të dokumenteve, materialeve të shkurta multimediale të bazuara në përmbajtjen e punësive ose përgjithësisht përmes postimit në lidhje me çështjen në faqen e internetit të FDH-së Kosovë dhe grupeve të Facebook-ut.

Nismat e këtyra deri tash kanë qenë të suksesshme dhe inkurajuese. Por, aksionet e tilla të imta dhe afatshkurta nuk janë të mjaftueshme me qëllim që në mënyrë efektive të trajtohet deficitin e qëndrueshëm i njohurive. FDH Kosovë, pikërisht si edhe të gjithë faktorët jo-shtetëror, nuk i ka mjetet e nevojshme ose prerogativat që në mënyrë sistematike të rrënojnë çështjet e drejtësisë tranzicionale në arsimin zyrtar. Zbatimi afatgjatë, institucional i qasjes në futjen e çështjeve të drejtësisë tranzicionale në arsimin formal mbetet brenda fushës së veprimeve shtetërore. Shteti i Kosovës është autoriteti i vetëm i duhur dhe legjitim për të ndryshuar përmbajtjet arsimore me qëllim që të pajis rininë e saj me arsimin cilësor dhe objektiv, i cili do t'i mundësojë atyre për të sendërtuar detyrat e tyre si qytetar. Në të vërtetë, kjo bie në përgjegjësinë e shtetit për të pajisur qytetarët e vet me mjetet e realizimit të të drejtave njerëzore të tyre fundamentale në arsimim: edhe pse domosdoshmërisht nuk është e artikuluar kështu, përgjegjësia e shtetit për të pajisur rininë e vet me arsimim cilësor mund të nxirret nga dokumente të ndryshme ndërkombëtare.<sup>12</sup>

<sup>11</sup> Shih aneksin 2.

<sup>12</sup> Shih *inter alia* UNESCO, [Deklarata Botërore mbi Arsimin për të Gjithë](#) dhe Korniza për Veprim për Përmirësim të Nevojave Bazike të të Mësuarit (1990), e miratuar nga Konferenca mbi Arsimin për të Gjithë, 5-9

Futja e drejtësisë tranzicionale në arsimin formal nuk është një ide e re dhe shumë vende në tranzicion kanë vepruar kështu. Për shembull, Komisioni i së Vërtetës dhe i Pajtitimit i Perusë është angazhuar së bashku me Ministrinë e Arsimit që nga fillimi, duke u interesuar për mënyrat se si të inkorporojë gjetjet e veta në sistemin e arsimit. Në Sierra Leone, Gjykata Speciale për Sierra Leonen ka organizuar diskutime lidhur me punën e saj me nxënësit anë e kënd vendit si pjesë e përpjekjeve të punës të saj në terren. Në Afrikën e Jugut, qeveria ka ndërmarrë një reformë shumë të gjerë arsimore, e cila ende është në vazhdim e sipër edhe sot e gjithë ditën duke e trajtuar të kaluarën e saj të padrejtë.<sup>13</sup>

Përfshirja e drejtësisë tranzicionale në planprogramet zyrtare të edukimit qytetar ka qenë objektivi final i programit të Edukimit Jo-Formal mbi Ballafaqimin me të Kaluarën të FDH Kosovë që nga fillimi. Për këtë qëllim, FDH Kosovë është duke u konsultuar me faktorë të ndryshëm lidhur me rëndësinë e çështjeve të drejtësisë tranzicionale dhe për përfshirjen e tyre të mundshme në planprogram: këtu përfshihen arsimtarët dhe drejtorët e shkollave të mesme, përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, OJQ-të përkatëse dhe ekspertë të arsimit.

Përfitimet e përfshirjes së një kapitulli të tillë janë të shumëfishta. Përveç trajtimit të pasojave negative të cekura më herët, një qasje institucionale ndaj kësaj çështjeje do t'i shërbente objektivit afatgjatë të arsimit të brezit të së ardhmes dhe bërjes së tyre më aktiv në procesin e trajtimit të së kaluarës dhe të ndërtimit të paqes. Bërja e drejtësisë tranzicionale pjesë e arsimit formal, duke pasur, kështu, miratimin e shtetit, do t'i jepte çështjes dukshmëri dhe autoritet më të madh dhe do të sinjalizonte angazhimin e shtetit ndaj zhvillimit të tij. Në Kosovë, përkrahja e qeverisë ndaj nismave të ndryshme të drejtësisë tranzicionale në nivel institucional, nëse do të përkrahej nga një qasje zyrtare arsimore e të mësuarit të të rinjve lidhur me përfitimet e tyre, do të ishte më autentike dhe më efektive. Përmes efektit të përhapjes, një përkrahje dhe ndërgjegjësim më i madh për masat e drejtësisë tranzicionale mund të zhvillohet në mesin e qarqeve shoqërore të studentëve, duke e shumëfishuar, si rezultat i kësaj, ndikimin e këtyre masave.

Në fund, futja e një kapitulli mbi drejtësinë tranzicionale është një prerogativë shtetërore, prej të cilës drejtpërdrejtë do të përfitonte shteti i Kosovës përmes ngritjes së besimit qytetar. Duke e pasur parasysh se arsimit është një nga shërbimet publike më të dukshme, cilësia dhe objektiviteti i tij si dhe rëndësia e përmbajtjes së tij janë çelës i përfundimit të besueshmërisë së sektorit të arsimit vis-à-vis popullatës (besimi qytetar vertikal) si dhe i promovimit të tolerancës, të të kuptuarit reciprok dhe përfshirjes midis qytetarëve (besimi qytetar horizontal). Përtej sferës kombëtare, futja e drejtësisë tranzicionale në arsimin formal – një angazhim i fortë i shtetit për njohjen dhe mos-përsëritjen e së kaluarës – do ta vendoste Kosovën në ballë të kërkimit të procesit të pajtimit rajonal, duke e forcuar rolin e saj si një partner i vlefshëm dhe i përgjegjshëm diplomatik.

---

mars 1990 ([World Declaration on Education for All and Framework for Action to meet basic learning needs](#) (1990), ose Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare, [Rekomandimet 1283 \(1996\)](#) *Historia dhe mësimi i historisë në Evropë* dhe [Rekomandimi 1880 \(2009\)](#) *Historia e mësimit të konflikteve dhe zonat post-konfliktuale* ([Reccomandations 1283 \(1996\)](#) *History and the learning of history in Europe* and [Recommendation 1880 \(2009\)](#), *History teaching in conflict and post-conflict areas*.

<sup>13</sup> Për më shumë hollësi, shih raportin e QNDT në Aneksin 3.

#### IV. KONKLUZION DHE REKOMANDIME

Pasojat negative, që rrjedhin nga mungesa e njohurive lidhur me çështjet e drejtësisë tranzicionale që e karakterizon rininë dhe shoqërinë e Kosovës janë të kthyeshme dhe të rinjtë përfaqësojnë një grup në shënjestër posaçërisht të rëndësishme për ta bërë këtë.

Veprimet e FDH Kosovë, që synojnë të fusin drejtësinë tranzicionale në shkollë, janë mirëpritur, por ato përbëjnë vetëm një pjesë të asaj që duhet të bëhet me qëllim që njëmend të adresohet problemi në mënyrën e kënaqshme. Kërkohej një qasje institucionale afatgjate, e cila zyrtarisht e fut drejtësinë tranzicionale në arsimin formal.

Për këtë qëllim, FDH Kosovë propozon rekomandimet e mëposhtme:

- Ministria e Arsimit në Kosovë duhet të ketë parasysh që arsimi është pjesë e përgjigjes së gjerë shoqërore ndaj të kaluarës së saj të dhunshme. Për këtë qëllim, ajo duhet të **punojë drejt futjes së një kapitulli mbi drejtësinë tranzicionale në tekstet shkollore të edukatës qytetare**, në një mënyrë që është e ndjeshme ndaj konfliktit, çështjeve gjinore, që është kulturalisht adekuate dhe e ndërgjegjshme në aspektin social-emocional.
  - Ky kapitull duhet të futet në tekstet shkollore të edukatës qytetare, më parë se sa tekstet shkollore të historisë, duke pasur parasysh se qëllimi i drejtësisë tranzicionale nuk është thjesht të mësoj për të kaluarën, por më parë të mësoj se si duhet të trajtohet ajo me qëllim që të formohen qytetar të ardhshëm të edukuar.
  - Ky kapitull në mënyrë të hollësishme duhet të informojë nxënësit lidhur me aspektet e drejtësisë tranzicionale që ekzistojnë (të katër shtyllat) dhe që janë të dobishme për të trajtuar të kaluarën, duke detajuar veçanërisht ato të cilat janë aktualisht në veprim në Kosovë. Po ashtu duhet të përgatis terrenin për nismat e së ardhmes të drejtësisë tranzicionale (Dhomat Speciale, KOMRA, etj.)
  - Ky kapitull duhet të synojë për të pajisur nxënësit me shkathtësitë e të menduarit kritik për të analizuar dhe interpretuar informacionin në mënyrë efikase dhe të përgjegjshme, për të njohur kompleksitetin e çështjeve dhe për të vlerësuar larminë kulturore. Duhet t'i shmanget përfshirjes së çfarëdo stereotipi ose çfarëdo shtrembërimesh të tjera të bazuara në paragjykimet kombëtare, raciale, fetare ose të tjera. Duhet të përfshijë të gjitha aspektet e shoqërisë (historinë sociale dhe kulturore si dhe atë politike) dhe duhet të bëjë njohjen e duhur të rolit të gruas. Në fund, duhet të përfshijë, si historinë vendore, ashtu edhe atë kombëtare (megjithëse jo atë nacionaliste) si dhe historinë e pakicave si dhe duhet të cek ndikimet reciproke pozitive.
- Në këtë proces, Ministria e Arsimit e Kosovës duhet të **konsultojë, të bashkëpunojë dhe të kërkojë përkrahjen e të gjitha palëve përkatëse** në këtë aksion. Kjo përfshin OJQ-të përkatëse – dhe në veçanti FDH Kosovë – praktikuesit e drejtësisë tranzicionale, ekspertët e arsimit, anëtarët e komisionit ndërmintor për trajtimin e së kaluarës, administratorët e shkollave, arsimtarët, prindërit dhe nxënësit. Konsultimi, në një shkallë të gjerë të palëve, do të sigurojë pronësinë e përpjekjeve për të arsimuar lidhur me trajtimin e së kaluarës dhe do të ndihmojë për të tejkaluar kundërshtimet e mundshme dhe do të ngrit përkrahjen për nisma.
  - Debatet, tryezat e rrumbullakëta dhe takimet me karakter konsultativ duhet të organizohen për shkëmbimin e ideve mbi të përmbajtjen dhe formën së këtij kapitulli. Qëllimi do të ishte që në mënyrën më të mirë të hartohet një

dokument multi-referencial, i cili i paraqet faktet në një mënyrë objektive, të qartë dhe të saktë dhe i cili e ka për qëllim të zhvillojë të menduarit kritik dhe shijen e debatit tek studentët.

- Ministria nuk duhet të supozojë se të gjitha palët do të jenë mbështetëse të reformës së planprogramit për të përfshirë drejtësinë tranzicionale dhe duhet të identifikojë pengesat, me të cilat ka gjasa që të sfidohet dhe t'i tejkalojë ato të cilat nuk janë të tilla.
- Ministria e Arsimit e Kosovës duhet të **bëj matjen e ndikimit potencial** të futjes së kapitullit të drejtësisë tranzicionale në plangprogramet e shkollave të mesme, para së gjithash përmes monitorimit të reaksioneve në klasat e mësimi.
  - Derisa futja e këtij kapitulli do të ketë pasoja pozitive, është e rëndësishme për të menaxhuar të pritmet përmes pranimi të kufizimeve të kësaj mase.
  - Ministria e Arsimit e Kosovës duhet të marrë parasysh se si të menaxhojë reaksionet, të cilat burojnë nga adresimi i historive potencialisht të ndjeshme dhe i narrativave në shkollë, siç janë zemërimi, ankthi, sikleti, poshtërimi dhe hakmarrja.
- Ministria e Arsimit e Kosovës duhet të ketë parasysh se **FDH Kosovë është duke ofruar ndihmën dhe ekspertizën e tij në të gjitha nivelet e këtij procesi** dhe se është i etur për të punuar në bashkëpunim të ngushtë drejt krijimit të sinergjive midis fushave të tyre respektive të drejtësisë tranzicionale dhe arsimit. Për shkak të punës së tij të mëhershme dhe të punës së tij në vazhdim e sipër, personeli i FDH Kosovë ka fituar një përvojë të konsiderueshme në trajtimin e të rinjve dhe në zgjimin e interesimit tek ata lidhur me debatin për drejtësinë tranzicionale si dhe e ka zhvilluar fleksibilitetin dhe përshtatshmërinë e nevojshme për të adresuar publikun nga radhët e të rinjve. Përveç kësaj, personeli i FDH Kosovë kohët e fundit ka hartuar një manual mbi drejtësinë tranzicionale<sup>14</sup>, i cili do të bëhet pikë referimi për aktivitetet e tij edukuese dhe i cili mund të formojë bazat e kapitullit të ardhshëm, megjithëse, në një formë të thjeshtësuar.

---

<sup>14</sup> Shih aneksin 3.

## ANEKSI 1.

### LISTA E PUNËTORIVE TË MBAJTURA

Në vitin 2015, FDH Kosovë ka mbajtur 16 punëtoritë e mëposhtme në shkolla të mesme të Kosovës, duke mbuluar në total mbi 591 nxënës:

1. **Hamdi Berisha** – Malishevë - 21.01.2015 ( kanë marrë pjesë 30 nxënës)
2. **Ulpiana** - Lipjan - 26.01.2015 (kanë marrë pjesë 31 nxënës)
3. **Ismail Qemali** – Kamenicë - 28.01.2015 (kanë marrë pjesë 36 nxënës)
4. **Shkolla Teknike Ekonomike (Tehnicka Ekonomska Skola) Vrbovc** - 03.02.2015 (kanë marrë pjesë 27 nxënës)
5. **Haxhi Zeka** – Istog - 18.02.2015 - ( kanë marrë pjesë 42 nxënës)
6. **Hamzë Jashari** – Skenderaj - 03.03.2015 (kanë marrë pjesë 37 nxënës)
7. **Ruzhdi Berisha** – Dragash - 10.03.2015 (kanë marrë pjesë 31 nxënës)
8. **Gjon Buzuku** – Prizren - 12.03.2015 (kanë marrë pjesë 62 nxënës)
9. **Vëllezërit Frashëri** – Deçan - 20.05.2015 (kanë marrë pjesë 35 nxënës)
10. **Skënderbeu** –Kaçanik – 01.10.2015 (32 kanë marrë pjesë nxënës)
11. **Mederesja e mesme Alaudin** – Prishtinë - 10.11.2015 (kanë marrë pjesë 33 nxënës)
12. **Dardania** - Han I Elezit - 13.11.2015 (kanë marrë pjesë 31 nxënës)
13. **Selajdin Mullaabazi - Mici** - Rahovec - 16.11.2015 (kanë marrë pjesë 35 nxënës)
14. **Xhevdet Doda** - Prishtinë - 24.11.2015 (kanë marrë pjesë 28 nxënës)
15. **Hoxhë Kadri Prishtina** – Prishtinë - 02.12.15 (kanë marrë pjesë 69 nxënës)
16. **Shkollën teknike “28 Nëntori”** - Prishtinë - 09.12.2015 (kanë marrë pjesë 32 nxënës)

Secila punëtori fillon me një film të shkurtër dokumentar, i cili nënvizon rreziqet e përmbajtura në shoqëritë, të cilat nuk e kanë trajtuar të kaluarën e tyre, dhe që janë frenuar nga zbatimi i katër shtyllave të drejtësisë tranzicionale. Filmi i shkurtër po ashtu shërben si themel për një debat, i cili më vonë hapë shtegun për një hyrje në Drejtësinë Tranzicionale. Në pjesën e dytë të Punëtorisë, FDH Kosovë i informon nxënësit shkurtimisht për historinë e Jugosllavisë (Shpërbërja: Lufta, Viktimat...etj.), me një përqendrim në Kosovën. Shembujt pastaj paraqiten para nxënësve, së bashku me faktet dhe me gjetjet dhe, pastaj, atyre iu mësohet në lidhje me të katër shtyllat e drejtësisë tranzicionale dhe veçantitë e tyre përkatëse.

Për një të kuptuar më të mirë të kësaj çështjeje si dhe për një angazhim më të madh, FDH Kosovë ua ofron nxënësve shansin për të marrë pjesë në një simulim të komisionit të së vërtetës: nxënësit marrin role të ndryshme (Komisionar, Viktima, Kryerës dhe Vëzhgues) dhe e simulojnë punën e komisioneve të së vërtetës gjatë dëgjimit publik. Nga ata, po ashtu, kërkohet një “raport” prej një paragrafi, i cili përmban rekomandimet e tyre.

## ANEKSI 2.

### ANALIZA E FORMULARËVE TË VLERËSIMIT

Në fund të secilës punëtori, nxënësit e plotësojnë formularin e vlerësimit të hartuar nga FDH Kosovë. Më poshtë është një analizë e 100 kopjeve të formularëve të vlerësimit të punëtorive të mbajtura nga FDH Kosovë gjatë vitit 2015, pra, kur të kihen parasysh dy gjenerata të ndryshme të nxënësve (ngaqë viti shkollor vazhdon nga Shtatori deri në Qershor).

Në mesin e 100 formularëve të analizuar, 40 prej tyre vijnë nga katër punëtoritë e fundit të FDH Kosovë në shkolla (pas shtatorit të vitit 2015, kur ka filluar një vit i ri shkollor/një gjeneratë e re). Të 60 formularët e tjerë janë marrë nga punëtoritë e mbajtura para muajit qershor të vitit 2015 (kur përfundon viti shkollor).

Analiza përqendrohet në tri pyetje specifike të nxjerra nga formularët e vlerësimit, në pjesën ku nxënësit pyeten për të dhënë përshtypjet e tyre lidhur me dobishmërinë punëtorive. Më poshtë janë rezultatet nga një shembull studimi. Duke e pasur parasysh se formularët e vlerësimit të zgjedhur sipas rastësisë janë të nxënësve të moshave të ndryshme, që i takojnë gjeneratave të ndryshme dhe që vijnë nga shkolla të ndryshme dhe rajone të ndryshme, supozimi është se rezultatet e nxjerra janë përfaqësimitare për një trend të përgjithshëm.

|  |             |
|--|-------------|
| <b>Unë kam fituar njohuri të reja</b>  | <b>95 %</b> |
| <b>Ky informacion nuk do të jetë i dobishëm për mua në të ardhmen</b>            | <b>5 %</b>  |
| <b>Ky informacion duhet të shtohet (të përfshihet) në tekstet tona shkollore</b> | <b>76 %</b> |

## ANEKS 3.

### HYRJE NË DREJTËSINË TRANZICIONALE

#### I. Domethënia dhe qëllimi: trajtimi i së kaluarës për ndërtimin e së ardhmes

Drejtësia Tranzicionale (DT) është, fjalë për fjalë, një formë e *drejtësisë* e përshtatur për shoqëritë në transformim pas një kapitulli të errët të historive të tyre dhe që kërkojnë të trajtojnë të kaluarën me qëllim që ajo kurrë të mos përsëritet.<sup>15</sup> Është një kornizë – ose një grup i praktikave – për adresimin e trashëgimisë së mizorive masive dhe abuzimit të të drejtave të njeriut në shoqëritë, të cilat janë duke u këndellur nga konflikti.

DT ka dy aspekte: është një **shikim prapa** (ajo merret me ngjarjet e së kaluarës), por, po ashtu, edhe një **shikim përpara**, ngaqë ajo përpiket të parandalojë përsëritjen e këtyre ngjarjeve.

DT mund të përfshijë masa të llojllojshme të ndryshme, siç janë ndjekjet penale (drejtësia ndëshkuese), reparacionet, kërkimi i së vërtetës (drejtësia restauruese), memorializimi (monumentet, ceremonitë, festat publike, deklaratat publike etj.), dhe reformat institucionale (siç është verifikimi).

Kjo llojllojshmëri e instrumenteve ilustron llojllojshmërinë e qëllimeve për DT-në: për të siguruar përgjegjësinë penale dhe për të siguruar llogaridhënien, për të sjellë riparimin/reparacionin për viktimat, për të krijuar një të vërtetë të përbashkët lidhur me atë se çfarë ka ndodhur, për të nxitur pajtimin individual dhe kombëtar, për të nxitur mundësitë për paqen në shtigje afatgjata, dhe për të avancuar sigurinë dhe zhvillimin e qëllimeve (siç është RGJD, dhe adresimi i pabarazive socio-ekonomike) si dhe sundimi i ligjit. Të gjitha nga këto qëllime janë të pritura për të trajtuar të kaluarën dhe për të ndërtuar të ardhmen.

#### II. Katër shtyllat kryesore të Drejtësisë Tranzicionale

Ekziston një zgjedhje e gjerë e instrumenteve të DT-së. Ato mund të ndahen në katër (4) shtylla kryesore.

##### 1) Ndjekja penale

Këto mund të kenë forma të ndryshme. Ato mund të jenë ndërkombëtare, siç janë gjykimet e mbajtura nga Tribunali Ndërkombëtar i Krimeve për ish Jugosllavinë (TNKJ-ICTY), Tribunali Ndërkombëtar i Krimeve për Ruandën (TNKR) ose Gjykata Ndërkombëtare Penale (GJNP). Ato mund të jenë vendore, siç është ajo e Dhomës së specializuar të Krimeve të Luftës e Gjykatës së Qarkut të Beogradit ose Departamenti i Krimeve të Luftës brenda Gjykatës së Shtetit në Bosnjë. Ato, po ashtu, mund të jenë hibride, me elemente të përziera ndërkombëtare dhe kombëtare, siç është ajo e Gjykatës Speciale për Sierra Leonen (GJSSL), ose gjykimet e mbajtura nga Misioni i Sundimit të Ligjit të BE-së (EULEX) në Kosovë.

Rëndësia e ndjekjeve penale pas konfliktit mund të konstatohet nga disa observacione. Së pari, dënimi i shkelësve e mundëson përforcimin e një kulture demokratike, duke i kontribuar, kështu, legjitimitetit të autoritetit të ri pas konfliktit si dhe forcimit të sundimit të

---

<sup>15</sup> Davis (2014).



ligjit, mbi të cilin do të ndërtohet ligji i ri. Llogaridhënia për veprat penale të së kaluarës është fundamentale për sigurimin e një rendi të ri të bazuar në sigurinë ligjore dhe llogaridhënieën qytetare. Po ashtu, ajo shërben për të krijuar besimin në institucionet e sapoformuara dhe për të financuar strukturat shtetërore në përputhje me normat ligjore ndërkombëtare. Duke i dhënë fund mosndëshkimit, gjykimet zbrapsin krimet e ardhshme dhe, së këndejmi, i kontribuojnë qëndrueshmërisë. Së dyti, gjykimet e realizojnë të drejtën fundamentale të viktimave për drejtësi. Duke i vënë prapa grilave ata, të cilët iu kanë bërë keq atyre, ajo e bën korrigjimin ndaj viktimave dhe është një pranim i rëndësishëm i vuajtjeve të tyre si dhe një akt i respektit ndaj kujtimit të tyre. Përmbushja e kësaj të drejte individuale është thelbësore për paqen dhe qëndrueshmërinë si dhe e bën të mundshme për viktimat që ato të vazhdojnë tutje me jetën e tyre. Në fund, nga gjykatat po ashtu mund të pritët që të ndihmojnë në arritjen e paqes sociale përmes pajtimit të ish armiqve, për arsye se ata e individualizojnë fajin dhe e largojnë përgjegjësinë nga masat. Duke i gjykuar ata, të cilët bartin përgjegjësinë më të madhe, është argumentuar kështu, mundësohet zvogëlimi i fenomenit të fajit kolektiv, që është një tipar i përsëritur i luftërave bashkëkohore qytetare, përmes ekspozimit të rolit të liderit në përkeqësimin e urrejtjes dhe manipulimin e opinionëve. Në një kontekst post-konfliktual, normalizimi i relacioneve midis dy komuniteteve më herët të kundërvëna, nuk mund të arrihet nëse nuk janë ndjekur penalisht në të dyja anët krimet e luftës, në mënyrë që mitet nga e kaluara, mbi të cilat të dyja komunitetet i kanë bazuar mendimet e tyre të papajtueshme, të jenë dekonstruktuar.

## 2) Masat e kërkimit të së vërtetës

Arritja e një versioni të përbashkët të historisë, e kujtimeve të përbashkëta të së kaluarës, është po ashtu thelbësore për pajtimin dhe për ecjen përpara. Kjo bëhet përmes proceseve të kërkimit të së vërtetës. Krijimi i një të vërtete zyrtare, për të cilën pajtohen të gjithë, mund t'i parandalojë gjeneratat e ardhshme nga rënia në revizionizëm, kurse elitat politike nga manipulimi i ngjarjeve nga e kaluara me qëllim të përshtatjes për agjendat e tyre politike. E vërteta po ashtu ua mundëson viktimave për të marrë korrigjimin dhe për të realizuar procesin e zisë së tyre. Derisa shumë instrumente të DT-së i kontribuojnë kërkimit të së vërtetës (siç janë gjykimet ose emërtimi i viktimave), instrumenti më i duhur është komisioni i së vërtetës.

## 3) Reparacionet

E drejta në reparacione është një aspekt jashtëzakonisht i rëndësishëm i ofrimit të drejtësisë për viktimat dhe, së këndejmi, një komponent thelbësor i drejtësisë tranzicionale. Në anën tjetër, reparacionet e bëra ndaj viktimave i kontribuojnë në njëfarë forme pranimit simbolik të humbjes së tyre, duke e mundësuar shërimin nga trauma e luftës. Ato ua mundësojnë viktimave për ta ushtruar të drejtën e tyre për të korrigjuar dhe janë një respekt për ata, të cilët i kujtojnë. Në anën tjetër, konfliktet e armatosura përgjithësisht i prekin grupet e varfra dhe të rrezikuara të shoqërisë në një mënyrë më të shprehur dhe, së këndejmi, reparacionet janë një element jashtëzakonisht i çmueshëm i drejtësisë së post-konfliktit nëse viktimat duhet të jenë në gjendje për të rivendosur dinjitetin e tyre, të rifillojnë jetët e tyre dhe të marrin pjesë në shoqëri në baza të barabarta.<sup>16</sup> Derisa kompensimi në të holla është forma më e zakonshme e reparacioneve, mund të përdoren shumë metoda të tjera (restitucioni, kompenzimi, rehabilitimi, satisfaksioni dhe garancitë e mos-përsëritjes), të gjitha që përmbajnë funksione të

---

<sup>16</sup> Stover (2005).

rëndësishme sociale dhe psikologjike të rehabilitimit, të reintegrimit dhe të respektit për ata që janë viktimizuar. Reparacionet simbolike përmes kërkimfaljes, pranimit dhe memorialëve po ashtu janë të dobishme për nderim të kujtimeve të viktimave dhe për konstatimin e fakteve.

#### 4) Reforma institucionale: ndërtimi i besimit në institucione

Në trajtimin e mizorive masive dhe të trashëgimisë së konfliktit, po ashtu është e domosdoshme që në mënyrë fundamentale të ndryshohen ato institucione përgjegjëse për shkeljet e të drejtave njerëzore, me qëllim të ripërtëritjes së sundimit të ligjit dhe të heqjes së kulturës së mosndëshkimit, e cila ka qenë e vendosur. Për arsye se institucionet publike (siç janë policia, ushtria dhe gjyqësia) shpesh bëhen instrumenti i shkeljes së të drejtave të njeriut gjatë konflikteve, është thelbësore pas tranzicionit për të filtruar dhe reformuar ato. Reforma institucionale është, së këndejmi, proces i rindërtimit të shtetit, me qëllim që t'i përmbahet respektimit të normave të të drejtave të njeriut dhe dispozitave të sundimit të ligjit si dhe spastrimit nga kryerësit e veprave penale për të siguruar llogaridhënien individuale dhe për të siguruar mos-përsëritjen. Reforma institucionale mund të përfshijë masat e shënjestrimit të mangësive individuale (proceset e verifikimit me qëllim të eliminimit ngas jeta publike të zyrtarëve abuziv dhe të korrumpuar) dhe mangësitë strukturale, përmes reformave organizative dhe ligjore (ristrukturimi i institucioneve, ligjet e reja dhe amandamentimet, reformat e sektorit të sigurisë, çarmatimi, demobilizimi dhe reintegrimi etj.), si dhe përmes masave edukative. Qëllimi i reformës institucionale brenda DT-së është që qytetarëve t'u dërgohet mesazhi se ata janë bartës të të drejtave dhe për të ndërtuar besimin midis tyre dhe institucioneve të tyre.

### III. Sfidat e Drejtësisë Tranzicionale

- **Secili instrument i DT i ka kufijtë e vet**

Derisa DT është një ndërmarrje shumë e rëndësishme, asnjëri prej mekanizmave të detajuar në dispozicion nuk është i përsosur dhe të gjithë ata kanë kufizimet e tyre inhereente. Ndjekjet penale, për shembull, janë të hartuara për shoqëritë, në të cilat shkelja e ligjit është e rrallë. Në konfliktet civile, siç janë ato të ish Jugosllavisë, ato shkelje shndërrohen në normë dhe, së këndejmi, ndjekjet penale sjellin një angazhim të rëndësishëm të kohës dhe të resurseve pothuajse të pamundshme për t'u siguruar, dhe kjo i ka çuar gjykatat ndërkombëtare për të proceduar me një selektivitet të madh. Për shkak të vëllimit të krimeve, njeriu duhet ta pranojë se ndjekja penale mund të jetë vetëm një mënyrë e pjesshme për trajtimin e shkeljeve sistematike të të drejtave të njeriut. Pos kësaj, fakti nëse këto ndjekje penale bëhen brenda ose jashtë ka një ndikim në efikasitetin e tyre. Në fund, gabimet në menaxhim të gjykimeve vendore dhe ndërkombëtare penale (çështjet e terrenit, mbrojtja e dëshmitarëve, perceptimi i gjykatave nga viktimat) shpesh e kanë penguar efikasitetin e tyre.<sup>17</sup> Reparacionet po ashtu përmbajnë rreziqe, ngaqë ato mund t'i përkeqësojnë tensionet politike. Ato mund të perceptohen si të paragjykuara nga disa viktimat. Përcaktimi se si duhet të shpërndahen reparacionet është politikisht i ndjeshëm dhe mund t'i lë ata që mbeten jashtë shumë të frustruar, duke krijuar mospajttime midis komuniteteve, duke e përkeqësuar pakënaqësinë dhe duke i marginalizuar edhe më tutje disa individë.

---

<sup>17</sup> Orentlicher (2010).

- **DT vepron në një kontekst shumë të ndjeshëm**

Njeriu duhet të mbajë në mend se DT është një ndërmarrje shumë e rëndë dhe e ndjeshme në një kontekst shumë kompleks dhe të paqëndrueshëm. Harku i gjerë i qëllimeve, i cili më herët është detajuar, është qartazi së tepërmi ambicioz për të qenë realist, për arsye se çështjet e larmishme që lindin pas konfliktit janë tepër komplekse për t'u zgjedhur nga vetëm një qasje ndaj DT-së. Pos kësaj, fusha e DT-së përfshin shumë vështirësi praktike: shkalla dhe natyra politike e krimeve, rreziku i ndryshimit të një bilanci delikat dhe krijimi i paqëndrueshmërisë si dhe rezistenca, e cila mund të bëhet nga lidërshipi kombëtar. Menaxhimi i të pritmeve është një element kyç i suksesit të DT-së nga publiku i përgjithshëm. Pos kësaj, nuk ka një zgjidhje të vetme e të zbatueshme në të gjitha kontekstet post-konfliktuale dhe secila shoqëri, e cila angazhohet në DT-në, duhet të zgjedh shtegun e saj vetjak, në pajtim me kontekstin kulturor dhe social. DT në mënyrë të skajshme është e kushtëzuar nga konteksti specifik dhe e varur nga trajtimi i viktimave. Është e ndjeshme, e politizuar dhe politike. Derisa e ka për qëllim për të ofruar një mënyrë përmes të cilës shoqëritë duhet të trajtojnë të kaluarën e tyre dhe për të arritur transformimin/tranzicionin afatgjatë, po ashtu ajo ka potencial të madh për destabilizim, keqpërdorim dhe keq menaxhim.

- **DT duhet të jetë shumëdimensionale dhe kontekstuale**

Nga të gjitha instrumentet e ndryshme të DT-së, asnjëri prej tyre nuk duhet të jetë i parapëlqyer, për arsye se të gjithë ata janë komplementar. Për shembull, derisa ndjekja penale e kryerësve është e domosdoshme, nuk është e mjaftueshme për të sjellë drejtësinë për viktimat, për arsye se e drejta në reparacione është e veçantë dhe po aq pjesë thelbësore e realizimit të drejtësisë post-konfliktuale për viktimat civile të krimeve të luftës. Njëmend, shumë studime tregojnë, kur iu është bërë pyetja lidhur me këtë, se viktimat nuk e përkufizojnë “drejtësinë” vetëm si ndëshkim të kriminelëve, por, po ashtu, si një grumbull të të drejtave sociale dhe ekonomike.<sup>18</sup> Në mënyrë të ngjashme, nëse disa kryerës të krimeve dënohen, por institucionet shtetërore mbesin të pushtuar nga zyrtarët abuziv, DT do të jetë me mangësi. Të pritmet e viktimave pas konfliktit janë të larmishme, për arsye se lufta i prek viktimat në shumë mënyra të ndryshme, dhe, së këndejmi, plotësimi i objektivave të DT-së kërkon përdorimin e mekanizmave të ndryshëm në dispozicion të përpiluar në një mënyrë holistike, kreative, specifike.<sup>19</sup>

#### **IV. Një pasqyrë e DT-së në Kosovë**

##### **1) Ndjekjet penale të krimeve të luftës të kryera në Kosovë**

Ndjekjet penale të krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë janë kryer nga tri mekanizma të ndryshëm. Në njërin anë, gjykimet ndërkombëtare në TNKJ janë marrë me rastet e profilit më të lartë. Në anën tjetër, sistemi gjyqësor i Kosovës është i angazhuar në ndjekjen e krimeve të luftës në nivel lokal me anë të ndihmës së Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe EULEX-it. Në fund, janë parë gjykime, po ashtu, edhe në gjykatat serbe. Kohët e fundit, është njoftuar se ndjekjet penale vendore do të zgjerohen me anë të themelimit të një gjykate të re, e cila shpesh është quajtur para publikut si “Gjykata Speciale” ose “Dhomat Speciale”, e cila do të trajtojë krimet e kryera nga ish

---

<sup>18</sup> Stover (2005).

<sup>19</sup> Davis (2014).

zyrtarët e lartë të ish Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) gjatë dhe menjëherë pas konfliktit në Kosovë. Krahas kompleksitetit të qartë të këtij sistemi, të cilit mund t'i mungojë transparenca, regjistrimi i krimeve të kryera në Kosovë ka qenë i përzier. Shumë vëzhgues e kanë denoncuar mungesën e rezultateve të TNKJ dhe e kanë kritikuar punën e UNMIK dhe të EULEX-it, duke ilustruar se sa komplekse është çështja e trajtimit të krimeve të së kaluarës në kontekstin e Kosovës.

## 2) Kërkimi i së vërtetës në Kosovë

Për shkak të karakterit rajonal të luftërave në ish Jugosllavi, duke e përfshirë konfliktin në Kosovë, dhe për shkak të lëvizjeve të viktimave dhe të kryerësve të krimeve përgjatë rajonit, bashkëpunimi rajonal duhet të jetë një element thelbësor i cilësdo përpjekje të Drejtësisë Tranzicionale. Procesi KOMRA<sup>20</sup> () është iniciuar me qëllim që të sigurojë një përpjekje kolektive, rajonale, të kërkimit të së vërtetës. Tash është i udhëhequr nga Koalicioni Rajonal për KOMRA-n me më shumë se 1,900 anëtarë, duke përfshirë organizata dhe individë nga shtetet post-jugosllave. Pas viteve të tëra të lobimit, pritet që Komisioni Rajonal i së Vërtetës do të themelohet në të ardhmen e afërt. Objektivi i gjithmbarshëm i KOMRA-s është që të krijojë një konsensus rajonal të bazuar në faktet lidhur me të kaluarën, me anë të të cilit të përparojë procesin e pajtimit midis komuniteteve të ndryshme dhe midis vet shteteve. Fatkeqësisht, agjenda kombëtare politike anë e kënd Ballkanit dhe niveli i ulët i vetëdijes për projektet rajonale brenda popullatës shpesh e pengojnë progresin në këtë fushë.

## 3) Reparacionet në Kosovë

Në Kosovë, Ligji<sup>21</sup> i cili parasheh reparacionet për krimet e luftës është i vërsuar nga shumë mangësi dhe në veçanti nga përkufizimi diskriminues i viktimave të luftës si dhe posaçërisht në disfavor të viktimave serbe të luftës në Kosovë. Paragjykimi i perceptuar kundër serbëve e përjetëson narrativin e gabuar “bardh e zi” lidhur me luftën, me çka parandalohet një narrativ i saktë dhe i bazuar në faktet. Po ashtu perceptohet si diskriminues dhe politikisht i motivuar, i tillë që krijon përçarje midis komuniteteve viktimë dhe aq i dëmshëm për pajtimin midis dy komuniteteve. Shfrytëzimi i reparacioneve simbolike, siç janë memorialët, është, po ashtu, shumë kontraverz në Kosovë, për arsye se promovon një histori të njëanshme të luftës.

## 4) Reforma institucionale në Kosovë – ndërtimi i besimit në institucione

Në Kosovë, derisa reformat strukturale dhe ligjore janë realizuar në kornizën kohore menjëherë pas konfliktit si pjesë e përpjekjeve për ndërtimin e shtetit, reformës institucionale ende i mungojnë disa aspekte. Në të vërtetë, nuk ka pasur një proces të verifikimit, dhe shumë nga udhëheqësit e njohur politik të shqiptarëve etnik në Kosovë kanë luajtur një rol aktiv në konfliktin e vitit 1999 si ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Derisa disa prej tyre janë ndjekur penalisht ose janë subjekt i hetimeve, shumë prej tyre thjesht kanë mbetur në pushtet dhe sot janë lider të shquar. Në drejtim të rimëkëmbjes së besimit të qytetarëve në institucionet e tyre, duket se detyra ka mbetur e pakryer. Shumica e serbëve etnik besojnë se

---

<sup>20</sup> Komisioni ndërshtetëror për Konstatimin dhe Zbulimin e Fakteve lidhur me Viktimat e Krimeve të Luftës dhe të Shkeljeve të të Drejtave të Njeriut në Territorin e ish Jugosllavisë nga viti 1991 – 2001.

<sup>21</sup> Emri i plotë i këtij ligji është: “Ligji mbi Statusin dhe të Drejtat e Martirëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale, Viktimave Civile të Luftës dhe të Familjeve të tyre”. Më tutje do t'i referohemi si Ligji mbi Reparacionet.

ekziston një mungesë e vullnetit të njëmendët politik për të mbrojtur të drejtat e komunitetit serb. Sistemi i gjerë ligjor dhe institucional në Kosovë e ka synuar mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesat e komuniteteve pakicë kurrë nuk janë zbatuar plotësisht si dhe as që kanë qenë efikas. Për shembull, derisa gjuhëve serbe dhe shqiptare iu është dhënë status i barabartë zyrtar në letër, në realitet është vështirë për t'iu qasur informacioneve dhe institucioneve publike në gjuhën serbe. Pos kësaj, popullata e shqiptarëve etnik, për shkak të skandaleve të përsëritura të korrupsionit, po ashtu nuk i beson institucioneve publike. Disa komentues argumentojnë se një nga sfidat kryesore të Kosovës në përparimet e saj të interesimit për DT-në është që të krijojë një besim të tillë.

**ANEKS 4.**

**RAPORT I QNDT, NËNTOR 2015**

**ARSIMI DHE DREJTËSIA TRANZCIONALE  
SHANSET DHE SFIDAT PËR NDËRTIMIN E PAQES**